

DEKRET
Nr.5350, datë 11.6.2007

**PËR KRIJIMIN E RRETHEVE GJYQËSORE, CAKTIMIN E KOMPETENCAVE
TOKËSORE DHE TË QENDRËS SË USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË TYRE**

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 11 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Në territorin e Republikës së Shqipërisë krijohen 21 rrethe gjyqësore me kompetenca tokësore dhe qendra të ushtrimit të veprimtarisë së tyre, si më poshtë:

1. Rrethi gjyqësor i Dibrës me qendër në Peshkopi, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Dibër e Bulqizë.

2. Rrethi gjyqësor i Sarandës me qendër në Sarandë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Sarandë e Delvinë.

3. Rrethi gjyqësor i Korçës me qendër në Korçë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Korçë, Devoll e Kolonjë.

4. Rrethi gjyqësor i Kukësit me qendër në Kukës, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Kukës e Has.

5. Rrethi gjyqësor i Beratit me qendër në Berat, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Berat, Skrapar e Kuçovë.

6. Rrethi gjyqësor i Shkodrës me qendër në Shkodër, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Shkodër e Malësi e Madhe.

7. Rrethi gjyqësor i Pukës me qendër në Pukë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Pukës.

8. Rrethi gjyqësor i Fierit me qendër në Fier, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Fier dhe Mallakastër.

9. Rrethi gjyqësor i Elbasanit me qendër në Elbasan, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Elbasan, Librazhd, Gramsh dhe Peqin.

10. Rrethi gjyqësor i Durrësit me qendër në Durrës, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Durrësit.

11. Rrethi gjyqësor i Kavajës me qendër në Kavajë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Kavajës.

12. Rrethi gjyqësor i Gjirokastrës me qendër në Gjirokastrë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Gjirokastrë, Përmet e Tepelenë.

13. Rrethi gjyqësor i Krujës me qendër në Krujë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Krujës.

14. Rrethi gjyqësor i Lezhës me qendër në Lezhë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet e Lezhës dhe Mirditës.

15. Rrethi gjyqësor i Kurbinut me qendër në Laç, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Kurbinut.

16. Rrethi gjyqësor i Lushnjës me qendër në Lushnjë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Lushnjës.

17. Rrethi gjyqësor i Matit me qendër në Burrel, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Matit.

18. Rrethi gjyqësor i Pogradecit me qendër në Pogradec, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Pogradecit.

19. Rrethi gjyqësor i Tiranës me qendër në Tiranë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Tiranës.

20. Rrethi gjyqësor i Tropojës me qendër Bajram Curri, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Tropojës.

21. Rrethi gjyqësor i Vlorës me qendër në Vlorë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Vlorës.

Neni 2

Me hyrjen në fuqi të këtij dekreti, shfuqizohet dekreti nr.2110, datë 29.5.1998 “Për krijimin e rretheve gjyqësore, caktimin e kompetencave tokësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë së tyre”.

Neni 3

Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij dekreti.

Neni 4

Ky dekret hyn në fuqi më 1.9.2007.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu